

Gabimet që studentët e Gjuhës Angleze bëjnë në përdorimin e fjalive të varura kohore

*Teuta Agaj**

Abstrakt

Të dish një gjuhë nuk do të thotë të dish vetëm fjalët e saj, por të dish si të lidhësh fjalët, renditjen e fjalëve në një fjali dhe renditjen e fjalive në një periudhë, rolin e tyre dhe marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën. Marrëdhënia e fjalive në një periudhë është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me fjalitë e përbëra me nënrenditje, në të cilat fjalitë nuk janë të njëjtit nivel, por tregojnë varësi. Pra, pikërisht fjalitë e varura kohore janë ato që janë mjaft të komplikueshme dhe të cilat krijojnë konfuzion. Për këtë arsye, shumica e njerëzve përpiqen t'i shmangin ato, dhe përdorin fjali të thjeshta në vend të tyre, megjithatë, diçka e tillë shkakton humbjen e kuptimit dhe origjinalitetit të idesë. Kjo do të thotë se edhe pse të komplikuar, fjalitë e varura kohore janë thelbësore për të shpjeguar idetë dhe mendimet tona. Duke u bazuar në numrin e madh të fjalive të varura kohore, në kuptimet që ato bartin, si dhe për mënyrën se si shprehet kuptimi, ky punim do të përqendrohet në gabimet që studentët e Gjuhës Angleze bëjnë në përdorimin e fjalive të varura kohore. Do të përqendrohet në strukturën e fjalive të varura kohore, si dhe përdorimin e tyre.

Fjalë kyç: *fjali, periudhë, fjali e varur kohore, fjali kryesore, fjali e varur, lidhëz nënrenditëse.*

Hyrje

Fjalitë ndajfoljore janë fjali të varura që funksionojnë si ndajfolje. Ato janë rrethanorë dhe për këtë arsye ato përcaktojnë foljen e fjalisë kryesore. Për më tepër, është lehtë t'i identifikosh ato për shkak që

* *Teuta Agaj, Kolegji AAB, email: teuta.agaj@aab-edu.net*

paraqiten me lidhëza nënrenditëse. Ato mund të vendosen kudo në periudhë: në fillim ose në fund të periudhës.

Rishikimi i Literaturës

Periudha me fjali të varur kohore është më e shumta në numër dhe përdoret më së shumti nga të gjitha periudhat e tjera me fjali të varur ndajfoljore. Periudha me fjali të varur kohore paraqitet me ndajfoljet e kohës të cilat përdoren edhe si lidhëza dhe shprehin kohën e veprimit të sintagmës foljore në fjalinë kryesore e cila mund të shprehë kohë të saktë, kohëzgjatje ose shpeshtësi. Megjithatë, sipas Nuhiut (2002), “Marrëdhëniet kohore midis fjalisë së varur dhe fjalisë kryesore mund të jenë të ndryshme: veprimet mund të jenë të njëkohësishme, një veprim mund të pasojë tjetrin, një veprim mund të paraprijë tjetrin, një veprim mund të fillojë në momentin kur përfundon veprimi tjetër, ose një veprim mund të zgjasë deri sa të fillojë veprimi tjetër etj” (f. 149).

p.sh. She sang as she drove home. – veprimi i fjalisë kryesore dhe i asaj të varur ndodhin në të njëjtën kohë.

He always reads an hour or so before he falls asleep. – veprimi në fjalinë kryesore e paraprin veprimin e fjalisë së varur.

As soon as he wakes up, he turns on the radio. – të dy veprimet e pasojnë plotësisht njëri-tjetrin.

The baby-sitter sang until the baby fell asleep. – veprimi i fjalisë kryesore ndodh deri sa fillon veprimi i fjalisë së varur.

Fjalia e varur kohore bashkohet me fjalinë kryesore me anë të këtyre lidhëzave: when, whenever, while, as, as soon as, as long as, till, until, since, after, before, hardly...when, scarcely...when, no sooner...than.

Sipas Azar (2009), “When – tregon se veprimet në fjalinë kryesore dhe në fjalitë kohore janë ose të njëkohësishme ose e pasojnë njëra-tjetrën; Whenever – e ka kuptimin ‘në çfarëdo kohe’, ‘kurdo qoftë’; While – e ka kuptimin ‘gjatë kohës që’, ‘në të njëjtën kohë që’; As – shpreh një fjali të varur në të cilën veprimi është në progres; As soon as – e ka kuptimin ‘në momentin që’, ‘jo më vonë se’; Till dhe Until – e kanë kuptimin ‘deri në momentin kur’; Since – e ka kuptimin ‘nga

momenti që' , 'pas momentit që' ; After – tregon se veprimi i fjalisë së varur kohore e paraprin veprimin e fjalisë kryesore ; Before – tregon renditje të ndryshme të veprimeve” (f. 368).

Në përgjithësi këto lidhëza shprehin diçka që ndodh duke iu referuar një periudhe kohore ose një ngjarjeje tjetër dhe ju përgjigjen pyetjeve 'when?' (kur?), since when?(që prej kur?) të cilat përdoren për të gjetur fjalinë e varur kohore.

p.sh. When I pass this exam, I will be very happy.

He proposed to her after he had known her quite well.

Before you go, bring me some water.

Lisa has lived in that house since she began to study.

I lived in Prishtina until I finished my studies.

Kur prin fjalinë kryesore, fjalia e varur ndahet me presje, ndërsa kur pason fjalinë kryesore, presja nuk përdoret.

Sipas Nuhiut (2002), “Fjalitë e varura kohore gjithashtu mund të realizohen edhe nga format e pashtjelluara të foljes si: fjali të varura me përcjellore (gerundial) të cilat paraqiten me parafjalën 'on' dhe tregojnë se veprimi në fjalinë kryesore fillon në momentin kur realizohet veprimi i shprehur në fjalinë e varur dhe fjali të varura me pjesore (participal) të cilat ndahen në pjesore të kohës së tashme dhe në pjesore të kohës së kryer” (f. 154).

p.sh. On arriving home, somebody called him.

Spending all the money, he came back home.

Having finished his studies, he got a job.

“Në fjalitë e varura kohore, koha e tashme në fjalinë kryesore kërkon kohën e tashme në fjalinë e varur kohore, koha e shkuar në fjalinë kryesore kërkon kohën e shkuar në fjalinë e varur kohore” (Eckersley, 1967, f. 338).

p.sh. He doesn't go to sleep until I read him a story.

She learned about her illness after she visited the doctor.

Megjithatë, koha e ardhme në fjalinë kryesore kërkon kohën e tashme ose kohën e kryer në fjalinë e varur kohore (Blaganje & Konte, 1979).

p.sh. He will study at home until his mother comes.

He will study at home until his mother has come.

Fjalitë e varura kohore kanë të njëjtën renditje si çdo fjali tjetër. Pra, kryefjala pasohet nga folja.

p.sh. He came while she was cooking.

I will wait until they call me.

The weather is cold when it is cloudy.

Metodat

Duke u bazuar në përvojën e ligjërimit të Sintaksës së Gjuhës Angleze në Universitetin AAB, kam vënë re se studentët e mi kanë vështirësi dhe bëjnë shumë gabime kur është fjala për përdorimin e fjalive të varura kohore. Kjo ndodh për disa arsye: së pari sepse ata nuk mund të bëjnë dallimin në mes të togfjalëshit dhe fjalisë, kështu që sa herë që ata kanë për të plotësuar një fjali (një fjali kryesore) me një fjali të varur kohore, ata përdorin një togfjalësh në vend të fjalisë së varur kohore, për shembull:

He was having dinner around ten o'clock. – togfjalësh parafjalor

He was having dinner after work. – togfjalësh parafjalor

A cow attacked your car yesterday. – togfjalësh ndajfoljor

I will ring you up tonight – togfjalësh ndajfoljor

My brother studied very hard all year. – togfjalësh emëror

A cow attacked your car this morning. – togfjalësh emëror

Pastaj ka raste kur ata ngatërrojnë lidhëzën, kjo do të thotë se në vend të përdorimit të një lidhëze kohore, ata përdorin një lidhëz të një lloji tjetër të fjalive të varura ndajfoljore për shembull:

The package came where he went in. – lidhëz vendore

My brother studied very hard because he had a lot of exams. – lidhëz shkakore

Për më tepër, periudhat e studentëve të mi gjithashtu përmbajnë gabime në lidhje me kohët e foljes, kjo do të thotë se ata përdorin kohë të ndryshme të foljes në fjalinë kryesore dhe në fjalinë e varur dhe kjo është arsyeja pse periudhat e tyre ndonjëherë nuk kanë kuptim në gjuhën angleze për shembull:

They left before the play is over.

Në fjalinë e varur është përdorur koha e tashme në vend të kohës së shkuar, kjo do të thotë që koha e shkuar duhej të ishte përdorur pasi që të dy veprimet kanë ndodhur në të kaluarën.

When Tom got home, we already had dinner.

Në fjalinë kryesore është përdorur koha e shkuar në vend të kohës më se të kryer ose kohës së kryer të tejkshkuar, kjo do të thotë që koha më se e kryer ose koha e kryer e tejkshkuar duhej të ishte përdorur pasi që veprimi në fjalinë kryesore ka ndodhur para veprimit të fjalisë së varur.

Gabimet janë gjetur edhe në identifikimin e fjalive të varura kohore në një fjali të përbërë me nënrenditje, sa herë që ata shohin lidhëzën 'kur' ata mendojnë se fjalia e varur e ka funksionin e një fjalie të varur kohore, për shembull:

When he will come doesn't depend on us.

Fjalia e varur e ka funksionin e një fjalie të varur kryefjalore pasi që mund të zëvendësohet me fjalën 'it'.

They don't know when he was coming.

Fjalia e varur e ka funksionin e një fjalie të varur kundrinore pasi që folja 'know' është folje kalimtare dhe foljet kalimtare kërkojnë një kundrinë.

The first thing to discover is when the victim was last seen.

Fjalia e varur e ka funksionin e një fjalie të varur të plotësorit kryefjalor pasi që folja 'is' është folje këpujore dhe fjalia e varur e përshkruan ose thotë diçka për kryefjalën.

The year when he graduated was a happy year.

Fjalia e varur e ka funksionin e një përcaktori të emrit dhe e përcakton emrin 'year'.

Duke qenë e vetëdijshme për gabimet më të zakonshme që studentët bëjnë në lidhje me fjalitë e varura kohore, më poshtë do të paraqes disa ushtrime të cilat ofrojnë praktikë të dobishme për studentët me qëllim për të përmirësuar gabimet që kam përmendur më lart. Secili lloj i ushtrimeve më poshtë ka për qëllim të demonstrojë se fjalitë e varura kohore janë të nevojshme kur komunikojmë.

Ushtrimi 1: Nënvizoni fjalitë e varura kohore në periudhat më poshtë.

a.was telephoning
c.telephoned

b.had telephoned
c.telephones

Gjetjet

Kemi vënë re se studentët plotësojnë fjalitë me një togfjalësh dhe jo me një fjali kohore siç kërkohet. Një tjetër lloj gabimi i gjetur në shkrimet dhe testet e studentëve është përdorimi i lidhëzave, kjo do të thotë se ata përdorin lloje të ndryshme të lidhëzave ose nuk përdorin fare lidhëza në vend që të përdorin lidhëzat kohore. Kemi identifikuar edhe gabime në përdorimin e kohëve në fjalitë e përbëra me nënrenditje, ka raste kur ata përdorin një kohë të foljes jo të saktë në fjalinë e varur kohore dhe si rezultat fjalia nuk ka kuptim dhe nuk është gramatikisht e saktë. Për më tepër, kemi vënë re se studentët gjithashtu kanë vështirësi të identifikojnë fjalinë e varur kohore në një fjali të përbërë me nënrenditje.

Përfundime

Si përfundim, mendoj se është e rëndësishme të njohim fjalitë e varura kohore. Studentët duhet të dinë se fjalia e varur kohore përbëhet nga një kryefjalë dhe një folje kryesore dhe nuk mund të qëndrojë vetëm, kjo do të thotë se ajo është fjali e varur. Prandaj, mund të themi se një fjali e varur kohore ka të njëjtin funksion si një ndajfolje apo togfjalësh ndajfoljor.

Bibliografia

1. Azar.S.B. (2009).*Understanding and Using English Grammar*. Prentice Hall Regents Englewood Cliffs, New Jersey.
- 2.Azar. S.B. (1993). *Chartbook. A Reference Grammar. Understanding and Using English Grammar*. Prentice Hall Regents Englewood Cliffs, New Jersey.
3. Blaganje, D. and Konte, I. (1979). *Modern English Grammar*. Drzavna Zalozba Slovenije. Ljubljana.

4. Celce-Murcia, M. & Larsen-Freeman, D. (1983). *The Grammar Book. An ESL/EFL Teacher's Course*. Cambridge: Newbury House Publishers.

5. Eckersley, C. E. & Eckersley, J.M. (1967). *A Comprehensive English Grammar for Foreign Students*, London: Longmans, Green and CO LTD.

6. Greenbaum, S. & Quirk, R. (1990). *A Student's Reference Grammar of the English Language*. Harlow: Longman.

7. Huddleston, R. & Pullum, K, G. (2002). *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge University Press.

8. Nuhiu, V. (2002). *English Syntax*. University of Prishtina, Prishtina.

9. Radford, A. (1988). *Transformational Grammar. A First Course*. Cambridge: Cambridge University Press.

10. Willis, D. (2003). *Rules, Patterns and Words. Grammar and Lexis in English Language Teaching*. Cambridge University Press.